Ferizaj: Hynë të maskuar të grabitin në një shtëpi, arrestohet njëri prej tyre

KRONIKA | February 13, 2023 - 11:44

SHPËRNDAJE:

Policia e Kosovës ka bërë të ditur se sot rreth orës 2:20 është arrestuar një person i dyshuar për grabitje.

This site

Sipas Policisë, një 61-vjeçar kishte informuar patrullën policore se persona të maskuar ishin duke vjedhur/grabitur në shtëpinë e tij.

"Patrulla e Policisë menjëherë është nisur në drejtim të shtëpisë dhe më pas në përforcim të tyre janë nisur edhe njësitet e tjera. Me të arritur te shtëpia kanë vërejtur se të dyshuarit ishin brenda shtëpisë dhe në përpjekje për t'i kapur në flagrancë të dyshuarit kanë kërcyer nga kati i dytë, duke u larguar nga oborri në fushë të hapur në drejtime të ndryshme.

Bëhet e ditur se pas ndjekjes së tyre, Policia kishte arritur ta ndalojë dhe arrestojë një person, i cili kishte rezistuar dhe kishte sulmuar zyrtarët policorë.

"Si dëshmi tek i dyshuari janë gjetur: stoli ari, një mjet i mprehtë (thikë) dhe një bateri ndriçuese", thuhet në komunikatë.

Policia bën të ditur se tre të tjerët janë larguar në drejtim të panjohur dhe se kanë nisur hetimet.

"Nga hetimet e para është mësuar se katër persona me maska kishin depërtuar me forcë brenda në shtëpi dhe sipas viktimës femër, kosovare e moshës 54-vjeçare, e cila ishte në gjumë me katër fëmijët e saj, posa kishte dëgjuar zhurmën arrin përmes telefonit ta njoftojë vjehrrin e saj, e që më pas ai njofton policinë, ndërsa viktima has të maskuarit, të cilët ishin me armë zjarri (pistoleta) në dorë. Të dyshuarit në prezencë të saj dhe fëmijëve, nën kërcënimin e armëve, kanë grabitur stoli ari dhe gjësende të tjera në vlerë rreth 20 mijë euro", thuhet ndër të tjera.

Bëhet e ditur se personi i arrestuar është I.R., mashkull, shqiptar, shtetas i Serbisë, i moshës 48-vjeçare, që është shoqëruar në Sektorin Rajonal të Hetimeve në Ferizaj për procedura të intervistimit, verifikimit dhe hetimit dhe me vendim të prokurorit të rastit dërgohet në mbajtje për 48 orë, ndërsa në kërkim policor mbeten të dyshuarit e tjerë të kësaj ngjarjeje. /**Zëri**

Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megazbritje.al | Sponsored

Albania: Weight Loss Solutions May Be Taking the Nation by Surprise
Weight Loss | Search Ads | Sponsored

Sapo ndodhi: Tërmet në Prishtinë
Dridhje të tokës janë regjistruar në kryeqytet para pak minutash. "Tërmet, ka mundësi të jetë ndier dy minuta më parë në Prishtinë, Kosovë", shkruan faqja për...
Zeri.info

Stair Lifts Could a Trend In 2022! - See Options Today!
Stair Lift | Search Ads | Sponsored

Më të lexuarat

KRONIKA | February 12, 2023
Arrestohet një burrë në Ferizaj, dyshohet se e dhunoi një 26-vjeçare në motel

KRONIKA | February 12, 2023
Theret për vdekje një person në Fushë-Kosovë

KRONIKA | February 11, 2023
U raportuan të zhdukura në Podujevë, dy të miturat policia i gjen në një kafene në Prishtinë

KRONIKA | February 13, 2023
Arrestohen personat që therën për vdekje 41-vjeçarin në Fushë-Kosovë

KRONIKA | February 13, 2023
Ferizaj: Hynë të maskuar të grabitin në një shtëpi, arrestohet njëri prej tyre

KRONIKA | February 12, 2023
Sveçla: Bashkëpronar i laboratorit të shkatërruar sot është i dyshuari që sulmoi Policinë e Kosovës në veri

Të rekomanduara



Zvicër, shqiptarja nga Kosova dënohet me 14...
February 13, 2023

2.3 milionë euro vlera e laboratorit të tretë...
February 12, 2023

Policia me aksion antidroge në veri të Mitrovicës
KRONIKA | February 12, 2023

Vjedhje në zyrat e "Bifurkacionit" në Ferizaj
KRONIKA | February 12, 2023

Arrestohen tre të dyshuar për vjedhje të rëndë në Prishtinë, i katërti ndodhet në arrati
KRONIKA | February 12, 2023

Komoran: Pronari kërcënon punëtorin se s'ia kreu punimet në shtëpinë e tij
KRONIKA | February 12, 2023

Prizrenasi sulmon gruan në Gjinekologji, arrestohet
KRONIKA | February 12, 2023

Gjendet e mitura që ishte shpallur e zhdukur, dyshohet se ishte dhunuar nga një mashkull
KRONIKA | February 12, 2023

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2010 Portali "Zëri".

redaksia@zeri.info
marketingu@zeri.info
Tel. + 383 38 24 90 71
Tel. + 383 38 22 24 51

Ky portal mirëmbahet nga NGB "Zëri" sh.p.k.. Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Zëriit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali, obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Dev: **S.A.P** - Design: **Trembelat**